

Gjykata Supreme e Kosovës
Prishtinë
Nr. i shkresës së lëndës: Api-Kzi 11/2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë prej
Maria Giuliana Civinini gjyqtare e EULEX-it e Gjykatës Supreme dhe Kryetare e kolegjit
Lars Dahlstedt gjyqtar i EULEX-it – anëtar i kolegjit
Marije Ademi gjyqtare e Gjykatës Supreme – anëtare e kolegjit
Nesrin Lushta gjyqtare e Gjykatës Supreme – anëtare e kolegjit
Salih Toplica gjyqtar i Gjykatës Supreme – anëtar i kolegjit

me asistencën e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Maria Rosa del Valle Lopez si procesmbajtëse, procesmbajtësen e gjykatës të EULEX-it Robina Struthers dhe Tsvetelina Zhekova dhe përkthyesen e EULEX-it Altina Ruli-Williams,

në praninë e Prokurorit të EULEX-it Jakob Willaredt, avokatit mbrojtës Xhefer Maliqi, përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar, avokatit Abit Asllani dhe të pandehurit Xhevat Haxha,

në seancën e mbajtur më 29 mars 2011 në orën 11 paradite në Gjykatën Supreme të Kosovës në lëndën penale kundër të pandehurit:

Xhevat Haxha, i biri i Xhafer Haxhës dhe Xhyla Rexhepit, i lindur më 3 maj 1960 në fshatin Prekaz, komuna e Skendarajt, me banim në rrugën 'Xhafer Deva', nr. 33, Mitrovicë, i martuar me nëntë (9) fëmijë;

I akuzuar për veprat penale Vrasje në Tentative në shkelje të nenit 146 të KPPK dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafi 2 i KPPK,

duke vendosur për ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit Xhevat Haxha, avokati Xhefer Maliqi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës P. Nr. 127/2008, të datës 16 shtator 2010,

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

MIRATOHET PJESËRISHT ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit Xhevat Haxha, avokati Xhefer Maliqi.

Aktgjykimi i gjykatës të shkallës së parë është ndryshuar në lidhje me dënimin në kushtet e mëposhtme:

- Për veprën penale Vrasje në tentative i pandehuri është dënuar me gjashtë (6) vite burgim.
- Për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve i pandehuri është dënuar me dy (2) vite burgim.
- Gjykata shqipton një **Dënim Unik prej Shtatë (7) Vite** burgim.

VËRTETOHET pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës P. Nr. 127/2008, i datës 16 shtator 2010.

Koha tashmë e kaluar në paraburgim do të llogaritet po ashtu si pjesë e dënimit.

ARSYETIM

1. *Historia e procedurës*

Më 24 nëntor 2008 Prokurori Publik paraqiti aktakuzën PP. nr. 108/08 në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës kundër Xhevat Haxha, duke e akuzuar për Vrasje në tentativë nga neni 146 në lidhje me nenin 20 të KPPK dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi 2 i KPPK.

Më 16 shtator 2010 Gjykata e Qarkut të Mitrovicës lëshoi aktgjykimin p. Nr. 127/2008 dhe shpalli fajtor Xhevat Haxhën për veprat penale Vrasje në tentativë dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe

në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe e dënoi të akuzuarin me pesëmbëdhjetë (15) vite burgim sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK.

Avokati mbrojtës i të pandehurit, avokati Xhefer Maliqi paraqiti ankesë me datën 11 nëntor 2010 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës P. Nr. 127/2008, të datës 16 shtator 2010.

Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, avokati Abit Asllani paraqiti përgjigje në ankesë më datën 5 janar 2011; po ashtu Prokurori Publik paraqiti përgjigje në ankesë me datën 3 mars 2011.

Aktgjykimi i tanishëm vendos mbi ankesën e datës 11 nëntor 2010 të paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i të pandehurit, avokati Xhefer Maliqi kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës P. Nr. 127/2008, të datës 16 shtator 2010.

2. Arsyetim

Në ankesën e tij, avokati mbrojtës ngrit çështjet e mëposhtme: (1) vërtetim të gabuar/ jo të plotë të gjendjes faktike, (2) zbatueshmëria e nenit 8.3 të KPK: tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe (3) vendim jo i duhur mbi dënimin: dënim i tepruar.

2.1. Vërtetim i gabuar/ jo i plotë i gjendjes faktike.

Sipas avokatit mbrojtës të pandehurit, aktgjykimi i shkallës së parë nuk sjell arsyetim për secilën pikë të aktgjykimit e as arsye bindëse për dënimin; sipas mendimit të tij aktgjykimi nuk vlerëson në mënyrë të saktë bazat dhe vërtetësinë e provave, në të kundërtën, aktgjykimi është i paqëndrueshëm në lidhje me faktet kyçe.

Në lidhje me këtë, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës p. Nr. 127-2008 vërteton faktet e mëposhtme: *“më 9 tetor 2008, Nazmi Mehmeti dhe Armend Bunjaku ishin ulur para dyqaneve të tyre në rrugën e Xhafërit. Në mes të Xhevat Haxhës dhe Nazmi Mehmetit u zhvillua një zënkë në lidhje me parkimin e veturave. Armend Bunjaku dëgjoi zënkën dhe u fut në mes të dy burrave me qëllim që t'i ndaj ata. Xhevat Haxha nxori revolen e tij - një Zastava M-70 pistoletë me kalibër 9x19mm. Mehmeti nuk ishte i armatosur. Dy burrat ishin disa metra larg njëri tjetrit kur Haxha filloi të shkrepe armën e tij. Haxha ka shkrepur së paku tre plumba në drejtim të Mehmetit. Mehmeti u përpoq të vraponte dhe të mbrohej prapa një veture por ishte qëlluar së paku me tre plumba në dorën e majtë, në shpatullën e*

majtë dhe në anën e majtë të kokës.

Prova e cila mbështet faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë është jashtëzakonisht e qartë dhe padyshim e tregon të pandehurin si kryerës të krimit:

I pandehuri vet ka dhënë deklaratën e mëposhtme në Drejtorin e Policisë Regjionale të Mitrovicës më 10 tetor 2008: *“dje më 09.10.2008, rreth orës 16:00 shkova në shtëpi nga prona e biznesit tim ku punoj dhe jam pronar (...). Kam pasur në dorë pistoletën time me kalibër 9x19mm të tipit Zastava, me ngjyrë të zezë. (...) Duke iu afruar atij (palës të dëmtuar Nazmi Mehmeti) e kam pyetur: “çfarë të kam bërë që je duke më sharë? Nazmiu u përgjigj: “Do t’i përdredh (palloj) gruan dhe fëmijët e tu”; Pastaj i thashë Nazmiut: “turp të qoftë që je duke më share me grua e fëmijë në praninë e tyre”. Pastaj Nazmiu u përpoq të më grushtoj dhe aty unë e kam nxjerrë pistoletën time dhe e kam mbushur. Kam bërë titur: “Zoti t’i verboftë sytë’ dhe kam shtënë në te. Nuk më kujtohet sa të shtëna kam shkrepur, dy apo tri herë. Kur e kam shkrepur një gjuajtje, distance në mes atij dhe meje ishte rreth një metër. Pas shkrepjes nga arma, kam vërejtur se Nazmiu ka rënë pasi kam shtënë në te. Menjëherë kam shkuar te vajza ime, Raba, në banesë që është mbi shitoren time, ku kam qëndruar derisa ka arritur Policia dhe më ka arrestuar. Pistoletën ua dorëzova atyre (Policisë).”*

I pandehuri konfirmoi deklarinimin e tij më 13.11.2008 te Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë Shyqyri Syla gjatë marrjes në pyetje të dyshimitit në Zyrën e Gjykatës Komunale në Vushtrri; po ashtu ai shtoi në deklaratën e tij të mëhershme: *“(…) arma ishte pa leje të organeve kompetente”.*

Ky deklarinim është konfirmuar plotësisht në “Raporti i Vendit të Ngjarjes” i datës 9.10.2008 lëshuar nga Mjekësia Ligjore Regjionale, Skuadra Regjionale e Krimit të Mitrovicës ku fotografitë me numër 47, 48, 49, 50 tregojnë qartë pistoletën ‘Crvena Zastrava’ M70 PARABELLUM me kalibër 9x19 të përshkruar nga i pandehuri dhe tri gëzhoja të plumbave të shënuar me numër D4, D5 dhe D6 të gjetur në vendin e krimit.

Në lidhje me këtë, Raporti i Ekzaminimit të Mjekësisë Ligjore, Laboratori Qendror i Mjekësisë Ligjore i Policisë së Kosovës i datës 26.12.2008 ekzaminoi gëzhojat e lartpërmendura të plumbave dhe arriti në konkluzion (faqja 3) se *“Provat e dorëzuara D4, D5 dhe D6 janë 3 gëzhoja të copave të plumbit të kalibrit 9x19mm, të shkrepur nga revolva CRVENA ZASTRAVA M70 PARABELLUM me kalibër 9x19 pa numër serik”.*

Gjithashtu, aktgjykimi i shkallës së parë bën një vlerësim shumë të detajuar të dëshmisë së palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti dhe dëshmitarëve Elfate Haxha, Naim Salihu, Zeqir Tahiri, Bekim Hodaj dhe Armend Bunjaku.

Në kuptim të kësaj, dëshmitarët Naim Salihu dhe Armend Bunjaku deklaruan në Polici e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor se ata e kanë parë të pandehurin duke shtënë në viktimën Nazmi Mehmeti.

Në të njëjtin kuptim, dëshmitarët Elfate Haxha, Zeqir Tahiri dhe Bekim Hodaj në deklaratat e tyre përkatëse në Polici deklaruan se ata e kanë parë të pandehurin duke shtënë në Nazmi Mehmetin; megjithatë gjatë shqyrtimit kryesor këta tre dëshmitar ndryshuan dëshminë e tyre dhe treguan se ata nuk e kanë parë atë.

Gjykata e shkallës së parë bën një vlerësim detal të provave dhe i jep besueshmëri dëshmive të palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti, dëshmive të dëshmitarëve Naim Salihu dhe Armend Bunjaku dhe deklarimeve në Polici të dëshmitarëve Elfate Haxha, Zeqir Tahiri and Bekim Hodaj. Kjo gjykatë plotësisht ndan dhe pranon vlerësimin e provave të bëra nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës.

Sipas Gjykatës Supreme, faktet janë vërtetuar drejt dhe qartë nga gjykata e shkallës së parë dhe kryerja e krimit nga i pandehuri është e pakontestueshme dhe absolutisht e provuar.

2.2. Zbatueshmëria e nenit 8.3 KPK: tejkalimi i kufijve i mbrojtjes së nevojshme.

Sipas avokatit mbrojtës të pandehurit: *“Po që se merret si i provuar fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, mbi bazat e deklaratave të dëshmitarit të dhëna në Polici, atëherë pa dyshim konkludohet se i akuzuari ka ndërmarr veprimin sepse viktima i ka thënë atij “(...) do të palloj nënë tënde nëse parkon përsëri (...)” dhe sepse viktima ka gjuajtur një gur mbi veturën e të akuzuarit, atëherë rezulton se i akuzuari ka vepruar mbi kufijtë e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme ose në mënyrë disproporcionale me shkallën e rrezikut, duke tejkaluar kufijtë mbi bazat e fakteve të provuara, për të cilat gjykata ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarit për shkak të mos-zbatimit të nenit 8.3 të KPK në lidhje me veprën penale nga neni 146 në lidhje me nenin 20 të KPK.”*

Mbrojtja e nevojshme është një shkak, arsye ose justifikim për kryerjen e veprës penale ndryshe e ndëshkuar me ligj. Mbrojtja e nevojshme ndikon në përgjegjësin penale dhe është esenciale një

definim i qartë i kufijve të saj. Në lidhje me këtë, janë dy kushte kyçe të cilat patjetër duhet të plotësohen: (a) agresioni i kundërligjshëm dhe (b) nevoja racionale për mjetet e përdorura për të shmangur ose zbrapsur agresionin.

Në lëndën momentale, asnjëri nga dy kushtet nuk janë plotësuar. E para, jo çdo lloj agresioni lejon justifikimin e veprimit kriminal; agresioni patjetër duhet të prodhojë një bindje racionale të rrezikut të atqasshëm dhe të vërtetë. Në këtë kuptim, sjellja e viktimës Nazmi Mehmeti në asnjë rast, nuk ishte një kërcënim apo rrezik për të pandehurin; sharja, mallkimi ose shkaktimi i dëmit në shkallë të ulët të pasurisë nuk është agresion i kundërligjshëm i kërkuar me nenin 8 të KPK.

E dyta, i pandehuri ka shtënë disa herë, madje edhe në kokë, në një person të paarmatosur i cili është përpjekur të vrapoj dhe fshehët prapa një veture. Në lidhje me këtë, **sjellja e të pandehurit është një veprim kriminal i pavarur i dhunës ekstreme dhe jo vetë - mbrojtje e asnjë lloji, proporcionale apo disproporcionale.**

2.3. Përkitazim me vendimin mbi dënimin ankesa është e bazuar.

Në lidhje me Vrasjen në tentative, sipas nenit 146 të KPK, vepra kriminale Vrasje duhet të dënohet me minimum pesë (5) vite burgim. Neni 20.2 i KPK vërteton se tentimi për të kryer një veprë penale të dënueshme me burgim prej më së paku tri (3) vite duhet të jetë e dënueshme; kufiri i dënimit për tentim është tri të katërtat e dënimit maksimal të përshkruar për veprën penale sipas nenit 65.2 të KPK. Po ashtu, afati maksimal i burgimit i lejuar me ligj është njëzet (20) vite.

Sa i përket, Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 328.2 të KPK duhet të dënohet me një gjobë deri në 10.000 Euro ose burgim prej një deri në tetë vite.

Gjykata e Qarkut të Mitrovicës vendosi të dënoj me dymbëdhjetë (12) vite burgim veprën penale Vrasje në tentative, katër (4) vite burgim veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe shqiptoi një dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) vite burgim sipas nenit 71 të KPK.

Gjykata Supreme vendosi të rishqyrtoj dhe ndryshoj dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës duke zvogëluar numrin e viteve të burgimit në kushtet e mëposhtme:

- Për veprën penale Vrasje në tentativa i pandehuri dënohet me gjashtë (6) vite burgim.
- Për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve i pandehuri dënohet me dy (2) vite burgim.
- Gjykata shqipton **Dënimin Unik prej Shtatë (7) Vite** burgim.

Me qëllim të vendosjes të zvogëlimit të numrit të viteve të burgimit, Gjykata Supreme ka marrë në konsideratë linjën në mes të dënimit maksimal dhe minimal, të gjitha rrethanat relevante në këtë lëndë dhe me kujdes i ka konsideruar aktgjykimet e saj të mëhershme në lëndët e ngjashme.

Veçanërisht, Gjykata Supreme ka marrë në konsideratë se, edhe pse pasojat e veprimit kriminal janë veçanërisht të rënda, nuk ka provë të aftësisë së kufizuar të përhershme të palës së dëmtuar si rezultat i sulmit; në të njëjtin kuptim, edhe pse veprimi ishte tejet i dhunshme, nuk ishte rezultat i një plani të paramenduar, por një veprim me një impuls të papritur. Gjykata Supreme ka vlerësuar në të kaluarën rrethana të ngjashme dhe 12 vjet burgim nuk është në rangun e zakonshëm të dënimit të miratuar në raste të ngjashme; për këto arsye, Gjykata Supreme ka vendosur uljen e dënimit dhe e ka shqiptuar një dënim unik prej shtatë (7) vjet burgim.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 22 prill 2011

Kryetarja e kolegjit:

 Maria Giuliana Civinini
 Gjyqtare e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Nesrin Lushta
Gjyqtare e GJS

Salih Toplica
Gjyqtar i GJS

Marie Ademi
Gjyqtare e GJS